



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT LUMOR ISHËM

VENDIM

Nr.11, datë 14/05/2026

PËR

**MIRATIMIN E LEJES PËR PËRDORIM BURIMI UJOR NËNTOKËSOR
PËR QËLLIME INDUSTRIALE, TË SUBJEKTIT "PETROL GAZ
TIRANA" SH.P.K, ME VENDNDODHJE: NJËSIA ADMINISTRATIVE
KASHAR, BASHKIA TIRANË.**

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 141, të ligjit nr.29/2024, "Për Burimet Ujore", i ndryshuar, dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.319, datë 11.06.2025, "*Për miratimin e formularëve të kërkesës për përdorim burimi ujar, dokumenteve shoqëruese, procedurës së shqyrtimit e vendimmarrjes, formateve të lejes, autorizimit, kushteve të posaçme dhe afateve të vlefshmërisë së tyre*", me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli Basenit Lumor Ishëm,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës për leje për përdorim burimi ujar nëntokësor për qëllime industriale, të subjektit "PETROL GAZ TIRANA" sh.p.k, me vendndodhje: Njësia Administrative Kashar, Bashkia Tiranë.
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Vendndodhja e burimit ujar (**pus-shpimi**):

- X= 480033.102
- Y= 4579472.282
- Z= 64 m

- Sasia e ujit që jepet në përdorim : $Q = 0.289 \text{ l/sek}$ (**25m³/ditë**)
- Qëllimi i përdorimit të ujit: Për përdorim teknologjik, proces ftohje.
- Thellësia e pus-shpimit: 27 m
- Thellësia e vendosjes së pompës : 25 m
- Koordinatat e pikës së shkarkimit:

$X = 480014.467;$

$Y = 4579440.056;$

$Z = 64.5 \text{ m}$

- Prurja që shkarkohet: $Q = 0.289 \text{ l/sek}$

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektivit.

KRYETARI I KBL ISHËM

ADRIAN GURRA

